REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJES**
**KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS**

Nr. 5150 Prot. Vau Dejes me 30.09.2022

**NJOFTIM PËR DËGJESË PUBLIKE**

Bazuar në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 18 pika 1 dhe pika 2 , neni 54 germa (e) dhe në rregulloren e brendshme për funksionimin e Këshillit Bashkiak Vau Dejës (VKB 23/2020) neni 154:

Këshilli Bashkiak Vau Dejës fton të gjithë banorët e fshatit Bushat ( të pajisur me dokument identifikimi), Njesia Administrative Bushat të bëjnë sugjerimet e tyre lidhur me projekt vendimin e meposhtëm:

**"Për dhënie pëlqimi në parim, për dhënien me qera të sipërfaqes prej 4160 m2, pjesë e pasurisë nr. 80/5, Zk. Nr 1329, e llojit kullotë, në fshatin Bushat, pronë e Bashkisë Vau Dejes. Fusha e përdorimit të pronës të jetë : Për mbareshtimin e faunës së egër dhe gjahut"**

Paraqitur nga:

(Drejtoria e Prokurimeve dhe Integrimit Sektori Aseteve)

Dëgjesa publike do të bëhet me datë **27.10.2022 ora 12.30** fshati Bushat,Njësia Administrative Bushat.

Gjithashtu ju ftojmë të bëheni pjesë e dëgjesës për projekt vendimin e mësipërm,nëpërmjet sugjerimeve tuaja në adresat elektronike:

(info@vaudejes.gov.al , ardian.celepija@vaudejes.gov.al , facebook – Këshilli Bashkiak Vau Dejës ).

**SEKRETARI KËSHILLIT**

**Ardian CELEPIJA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA VAU I DEJËS

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA VAU DEJES**
DREJTORIA JURIDIKE E PROKURIMEVE DHE INTEGRIMIT
SEKTORI I ASETEVE

**Projekt – Vendim**

Nr 08.date 26.09.2022

**Dhënie pëlqimi në parim, për dhënie me qira të siperfaqes prej 4160 m2, pjesë e pasurisë nr 80/5, Zk nr 1329, e llojit "Kullotë", në fshatin Bushat, pronë e Bashkisë Vau Dejës. Fusha e përdorimit të pronës të jetë; "Për mbarështimin e faunës së egër dhe gjahut".**

Në mbështetje të Ligjit nr 139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"*, ndryshuar, neni 8 pika 2, neni 9 pika 1/1, 2, neni 18, neni 54 shkronja "e/1" (ndryshuar), neni 55 pika 4, neni 27 pika 5, ligji nr 38/2019, ligji nr. 8744 datë 22.02.2001 *"Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njesitë e qeverisjes vendore"*, i ndryshuar. Në VKM nr. 246 dt 31.03.2011, *"Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr 68, datë 28.08.2008 të Këshillit të ministrave, për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme, publike të shtetit që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Bushat të Qarkut të Shkodrës"*," VKM nr 559, datë 29.07.2022, *"Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore."*, Udhëzimin nr 1, datë 09.06.2016 të Ministrisë së Mjedisit *"Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik"*, në VKB nr 34, dt 26.05.2022 *"Për miratimin në parim të listës së pasurive të llojit "Kullotë" të gatshme për dhënie në përdorim"*, të shkresës nr 368/1, prot, dt 08.06.2022, të Prefektit të Qarkut Shkodër, i propozojmë Këshillit të Bashkisë Vau Dejes, të:

**VENDOSI :**

1. Miratimin në parim të dhënies me qira me anë të konkurimit me afat 10 vjeçar, të sipërfaqes prej 4160 m2, sipas plan rilevimit bashkëlidhur, e llojit "Kullotë", pjese e pasurisë nr 80/5, Zk nr 1329, fshati Bushat, NJAD Bushat, pronë e Bashkisë Vau Dejës, me çertifikatë pronësie.

2. Efektet: Jep impakt pozitiv në komunitet duke hapur vende të reja pune, si dhe sigurohen të ardhura për Bashkinë, që kthehen më pas në investime publike.

3. Vlera dysheme e qirasë vjetore, të jetë sipas VKM-së Nr 559, datë 29.07.2022, *"Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore"*.

4. Pas miratimit në Këshill dhe shprehjes së ligjshmërisë nga ana e Prefektit të Qarkut, do të vazhdohet procedura për dhënien në përdorim të kësaj pasuie, duke bërë shpalljen në Buletinin e Njoftimeve Publike sipas afateve ligjore, për të vijuar më pas me pranimin e ofertave dhe konkurimin publik me të gjithë elementët përbërës të tij, deri në vlerësimin e ofertës fituese, dhe më pas me lidhjen e kontratës.

**KRYETARI**
**Mark BABANI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA VAU I DEJËS

*Konceptoi: Armand Filipi*

*Miratoi: Ndoc Bagli*

Adresa: "Rruga Qafa e Gurit" Vau Dejes, Telefon/Faks 00355 2612 0006 , e-mail: info@vaudejes.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS**
DREJTORIA JURIDIKE PROKURIMEVE DHE INTEGRIMIT
SEKTORI I ASETEVE

Nr _______Prot Vau Dejës me ____ . ____ 2022

# RELACION

**Këshillit Bashkiak Vau Dejës**

Të nderuar këshilltarë,

Administrimi i fondit pyjor dhe kullosor në territorin e Bashkisë Vau u Dejës, është një ndër funksionet e Bashkisë, i përcaktuar në nenin nr 27 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ku në piken 5 të këtij neni përcaktohet: Funksionet e Bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit:
Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve pika *5. Administrimin e fondit pyjor dhe kullosor publik, sipas legjislacionit në fuqi.*
Ligji bazë mbi të cilin kryhet administrimi i fondit Pyjor/ Kullosor është ligji nr. 57/2020 "Për pyjet ", si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
Bazuar në Ligjin nr 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore",neni 9 pika 1.2 c , neni 54 pika el, neni18, është kompetencë e Këshillit të Bashkisë , dhënia me qira të tretëve të pronave të Bashkisë.
Udhëzimi i Ministrit të Mjedisit nr. 1 datë 09.06.2016 " Për rregullat , procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik" pika 7.
*Siperfaqja e marre ne studim do te dale ne ankand* nepermjet procedures se prokurimit publik sipas legjislacionit ne fuqi.

**Siperfaqja që kërkohet të merret në përdorim është 0.416 Ha.**
**Në funksion të siperfaqes që merret në përdorim, sipas** VKM-së nr. **559, datë 29.07.2022** "*Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor/kullosor kombëtar,për veprimtari ekonomike,si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore*",Shtojca 1, pika 8/4, si dhe bazohen në afatin kohor sipas grafikut të punimeve të miratuar nga institucioni përkatës dhe kategorinë e përdorimit **si më poshtë.**

| 8. Për mbareshtimin e faunws sw egwr dhe gjahut. | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Nr. | Përdorimi i territorit | Siperfaqia e përdorur në Ha | Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/Ha/vit | |
| | | 1 vit | 2- 5 vjet | 6-10 vjet |
| 1 | Kullote | 24 000 | 23 000 | 20 000 |

**Nga llogaritja e vlerave sipas tabelws mw sipwr del: Sip 0.416 Ha x 20 000 lek/Ha ne vit = 8 320 leke/vit.**

Për sa më sipër, propozojmë dhënien në përdorim të sipërfaqes prej 0.65 ha të llojit Kullotë, në fshatin Barbullush.

Grupi i punws

Mark Suli　　　　Ndoc Baqli　　　　Esmeraldo Harapi

**KRYETARI**
**Mark BABANI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA VAU I DEJËS

**Bashkia Vau Dejës** ***Shtojca nr. 1***

# RAPORT

MBI STUDIMIN TEKNIKO-EKONOMIK PËR DHËNIE NË PËRDORIM NGA FONDI KULLOSOR TË SIPËRFAQES NË PRONËSI TË BASHKISË VAU DEJËS, "PËR MBARESHTIMIN E FAUNËS SË EGËR DHE GJAHUT.

Bazuar në Urdhërin **nr.28, datë 02.02.2022** të Kryetarit të Bashkisë për vlerësimin tekniko-ekonomik të sipërfaqes pyjore për dhënie të fondit pyjor me qira "Grupi i punës i përbërë nga z.Ndoc Baqli, Përgjegjës i sektorit të Aseteve, z. Mark Suli, specialist i administrimit të pyjeve, z.Esmeraldo Harapi Ing Specialist kadastre, nga data **14.09.2022** deri në datën **16.09.2022**, realizoi verifikimin në terren dhe në regjistrin kadastral të sipërfaqes kullosore, me objekt dhënien në përdorim të siperfaqes kullosore prej **0.416** ha, *"Për mbarështimin e faunës së egër dhe gjahut"*.

Mbështetur në të dhënat e rregjistrit kadastral pyjor/kullosor sipas VKM nr.246, datë 31.03.2012, *"Për disa shtesa dhe ndryshime ne vendimin nr 68 date 28.01.2008 të këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike ,shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Bushat të Qarkut të Shkodrës"*,rezulton se sipërfaqja e kërkuar që merret në përdorim është **0.416** ha, pjesë e pasurisë nr 80/5, Zk nr 1329 fshati Bushat, në pronësi të Bashkisë Vau Dejës, me çertifikatë pronësie.
Përshkrimi parcelar i sipërfaqes objekt studimi dhe kategoria e përdorimit të saj pasqyrohen në tabelat 1 dhe 2 të këtij raporti.

Nga verifikimi në terren rezulton kjo gjendje: *(sipas tabelave përkatëse Bashkelidhur).*
Ndërhyrjet e propozuara që pasqyrohen në dokumentacion jepen në përdorim me afat deri **10 vjet,** një siperfaqe prej **0.416 ha** " Për qëllime pushime, argetimi, veprimtari turistike" etj
Procedurat që ndiqen për dhënien në përdorim/heqjen nga fondi pyjor dhe kullosor publik janë të mbështetura në V.K.M-ve nr. 1353,datë 10.10.2008,të ndryshuar *"Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe proçedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor"*, në VKM-ve nr 1374, date 10.10.2008, të ndryshuar *"Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor"*. Udhëzimin e Ministrit te Mjedisit nr.1 datë 9.06.2016 *"Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik"* pika nr 2 germa (a) dhe pika 7.

Siperfaqja e marrë në studim do'ti nënshtrohet procedurës së Konkurimit publik sipas legjislacionit në fuqi.

Pas miratimit të raportit tekniko - ekonomik dhe akteve të tjera normative si më sipër, Kryetari i Bashkise nxjerr urdhërin për pergatitjen e dokumentave të ankandit nëpërmjet proçedurës së kunkurimit publik.

Tarifat e dhënies në përdorim nga fondi pyjor kullosor bazohen në VKM-**në nr.559, datë 29.07.2022** *"Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të*

*fondit pyjor kombëtar,për veprimtari ekonomike,si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore*",Shtojca 1, pika 8/4, si dhe bazohen në afatin kohor sipas grafikut të punimeve të miratuar nga institucioni përkatës dhe kategorinë e përdorimit.

**Shuma në lek/vit konsiston në:**

**1. Vlerën e përdorimit leke/ha/vit për "Për mbarështimin e faunës së egër dhe gjahut"**

Pasuria nr 80/5, Zk nr 1329, me sipërfaqe kullote prej 0.416 ha x 20 000 leke per ha/vit = **8 320 lekë/vit.**

**PËRPILUESIT E RAPORTIT TEKNIKO-EKONOMIK**

**Ing. Mark Suli** **P/sek Ndoc Baqli** **Ing. Esmeraldo Harapi**

**KRYETARI**

**Mark BABANI**

REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA VAU I DEJËS

Bashkia Vau Dejës

PASQYRE E PERSHKRIMIT PARCELAR ( sipas regjistrit kadastral)

Për mbarështimin e faunës së egër dhe gjahut

Formulari nr.1

| ID. Prones | Ekonomia Pyjore | Parcela | Sip.Tot. ha | Perberja grumbullit | Funksioni | Forma Qeverisjes | Mosha | K.D | Te dhena te grumbullit pyjor | | | | | Fuqia lendore | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | D mes | Lart. mes | Filizeria | Nen pylli | Katet | Per ha | Total |
| **1329** | Bushat | **80/5** | 0.416 | Kullotë | Kullotë | Kullotë | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |

Bashkia Vau Dejës

PASQYRE E PERSHKRIMIT PARCELAR ( sipas verifikimit ne terren)

Për mbarështimin e faunës së egër dhe gjahut

Formulari nr. 2

| ID. Prones | Ekonomia Pyjore | Parcela | Sip.Tot. ha | Perberja grumbullit | Funksioni | Forma Qeverisjes | Mosha | K.D | Te dhena te grumbullit pyjor | | | | | Fuqia lendore | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | D mes | Lart. mes | Filizeria | Nen pylli | Katet | Per ha | Total |
| **1329** | Bushat | **80/5** | 0.416 | Kullotë | Kullotë | Kullotë | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |

**PLOTESOI:**

**Ing.Esmeraldo Harapi** **Ing.Mark Suli** **Ndoc Baqli**

**Bashkia Vau Dejës**

## TABELA PERMBLEDHESE E VLERESIMIT FINANCIAR

Për mbarështimin e faunës së egër dhe gjahut

**Formulari nr.4**

| Perdorim i I territorit | Sip ha | Bashkia | Volumi ne $m^3$sipas asortimenteve | Sasia | Vlera Leke /m3 | Shuma I | Gjatesia e perdorimit rruge ne | Tarifa dhenie ne perdorim lek/ha/vit | | | Shuma II | Totali I+II |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | 1 | 2.-5 | 6.-10 | | |
| 0 | 1 | 2 | 3 | | 4 | 5 | 6 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 |
| Pyll | 0 | V.Dejës | 0 | 0 | **0** | **0** | 0 | 0 | **0** | **0** | 0 | **0** |
| Pyll | 0 | V.Dejës | 0 | 0 | **0** | **0** | 0 | 0 | **0** | **0** | 0 | **0** |
| Kullote | 0.416 | V.Dejës | 0 | 0 | **0** | **0** | 0 | 24 000 | 23 000 | 20 000 | **8,320** | **8,320** |
| Gjuetia | 0 | V.Dejës | 0 | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Invest | 0 | V,Dejës | 0 | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| **Gjithsejt** | 0.416 | | | | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **8,320** | **8,320** |

## LISTA E NGASTRAVE, N/NGASTRAVE TË FONDIT PYOR DHE KULLOSOR PUBLIK QË HIQEN/JEPEN NË PËRDORIM

Për mbarështimin e faunës së egër dhe gjahut

| Nr. | ID Prones | Ekonomia Pyjore/kullosore | Ng/neng,nr. | Siperfaqie qe hiqet nga fondi | Siperfa qe jepet ne perdorim nga fondi pyjor/kullosor | Gjatesia ne perdorim km | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Rruge km | Linje | Tubacion /kanal |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 |
| 1 | 1329 | Bushat | 80/5 | 0 | 0.416 | 0 | 0 | 0 |

**PLOTËSOI:**

**Ing.Mark Suli** **Ndoc Bagli** **Ing .Esmeraldo Harapi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

# ÇERTIFIKATË

## PËR VËRTETIM PRONËSIE

407053

Zyra e Regjistrimit SHKODER Zona Kadastrale Nr. 1329

Numri i Pasurisë 80/5 Volumi 9 Faqe 54

Adresa e Pasurisë BUSHAT- SHKODER

Lloji i Pasurisë KULLOTE

Sipërfaqja Totale 51.407 m2 (PESEDHJETE E NJEMIJE E KATERQINDE E SHTATE) m2

Nga kjo : Sa Truall - Nga kjo : Sa Ndërtesa -

Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes - %

## KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti ( Zotërinjtë )

| Emri | Atësia | Mbiemri | Pjesa | Adresa |
| --- | --- | --- | --- | --- |
| KOMUNA | | BUSHAT | I | BUSHAT |

- është pronar i PASURISE ME NR. 80/5
- janë bashkëpronarë sipas pjeseve më lart -
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi -
- kufizimet e pasurisë janë : V 80/2, 818/2, L 818/4, J 85, 80/6, P 80/6, 80/2

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së paragjitur nga i (të) interesuari (t) më datë 13.09.2011 Nr. 374

Data e lëshimit të çertifikatës

13.09.2011

Lëshuesi i çertifikatës

REGJISTRUESI

( NERTIAN KALAMISHI )

# HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

*(Fragment)*

| ZYRA E REGJISTRIMIT E PASURIVE TE PALUAJSHME | A. IDENTIFIKIMI I PASURISE |
|---|---|
| SHKODER | ZONA KADASTRALE 1329 NR. I PASURISE 80/5 VOL. 9 FQ. 54 |
| ING. G. TERNOVA | INDEKSI I HARTES K-34-76-(2-C) SHKALLA 1:2500 |
| | ADRESA E PASURISE: Rrethi SHKODER Q/F BUSHAT |
| | Rr/L ________ P/G ______ Sh _____ K _____ Ap _____ |
| | **B. KUFIZIMET** / **C. PRONARI** |
| | V. 80/2, 818/2 |
| | L. 818/4 — KOMUNA "BUSHAT" |
| | J. 85, 80/6 |
| | P. 80/6, 80/2 — S= 51 407 m2 |
| Vula. | D. Data: 13/9/2011, Ora: ________ |



# PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

ROSITES: LUIGJ KOLË SHKRELI — DATE: 16.07.2022 — QELLIMI: MARRJE ME QERA

**ENDNDODHJA**

SHKIA: VAU DEJES — DV. ASHK: SHKODER — ZONA KADASTRALE: 1329 — NR. I PASURISE: 80/5 — VOL. 9 FQ. 54 — INDEKS HARTE: K-34-76-(2-C)

**DHENAT E PASURISE**

OJI I PASURISE: KULLOTE — SIP. PASURISE: 4160 $m^2$ — SIP. TRUALLIT: 0 — SIP. NDERTESES: 0 — NUMRI KATEVE: 0 — NUMRI PEMEVE: 0

## KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

Y — X,Y




**SHPJEGUES**

Siperfaqe:

S=4160 $m^2$

Parcela me nr pasurie 80/5 sipas hartes kadastrale S=51 407 $m^2$

Parcela me nr pasurie 80/5, pjesa S sipas matjeve faktike S=4160 $m^2$

,Y — X,Y

SHKALLA 1:2500

V — P — L — J

| R | ORIENTIMI | Nr. PASURISE | TIPI I KUFITARIT | KUFITARI | ID/NIPT | SHENIME |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | VERI | | | | | KUFIZIMET E PASURISE 80/5 |
| | JUG | | | | | KUFIZIMET E PASURISE 80/5 |
| | LINDIE | | | | | KUFIZIMET E PASURISE 80/5 |
| | PERENDIM | | | | | KUFIZIMET E PASURISE 80/5 |

**REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT**

EMRI: ESMERALDO HARAPI

LICENCA: NR. T.1489 — DATE: 10.05.2021

NENSHKRIMI / VULA:

ING. GJEODET ESMERALDO HARAPI LICENCE T.1489

**KONFIRMOI**

PERGJEGJESI / DREJTORI

**TEKNOLOGJIA E MATJEVE:** T-Terren, O-Ortofoto, Z-Zyre

Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren, Z-Zyre, O-Ortofoto, G-GPS, S-Stacion Total, D-Matje Distancash

**PERCAKTIMI I KUFIRIT:** P-Perfaqesues i Pronareve, HK- Harte Kadastrale

Kode per percaktimin e kufirit: P-Perfaqesues i Pronareve, K-Kufitaret te Gjithe, KP-Kufitaret Pjeserisht, PB-Perfaqesues Bashkie, HK-Harta Kadastrale

**SHENIME TE VECANTA:**

**PRONARI / BASHKEPRONARET**

EMRI: LUIGJ SHKRELI